

Albanisch

BIRI I HYJIT U BË NJERI PËR NE

LETËR BARITORE

për kohën e kreshmëve të pashkës 2025
nga dr. Georg Bätzing, ipeshkëv i Limburgut

„KY ËSHTE BIRI IM – I ZGJEDHURI, ATË DËGJOJENI.”
(Lk 9,35)

Të dashur vëllezër dhe motra në fe! Kush i njeh rrënjët e veta, mund të rritet dhe t'i përballoj sfidat me sukses.

Kjo vlen si për jetën ashtu edhe për fenë. Me këtë letër baritore, dëshiroj që ta kthej vëmendjen tuaj kah kredo, pra kah dëshmia e fesë, e cila në thelbin e vet u formulua saktësisht 1700 vjet më parë, dhe disa dekada më vonë mori formën sipas së cilës e njohim edhe sot kur ende e quajmë “Besojma e Madhe”; kjo besojmë qysh prej asaj kohe ka siguruar për kishën dhe për besimtarët e saj themele të forta të cilat kanë mundësuar rrugëtimin e tyre në kohë.

Fillimisht, “Besojma e Nikesë” u formulua në greqisht, pasi ajo ishte gjuha që përdorej në rrethanat e krijimit të saj.

PËRPJEKJA PËR UNITET PAS KTHESËS KONSTANDINIANE

Konstandini i Madh ishte perandori i parë romak që u rreshtua hapur në krah të të krishterëve, dhe së bashku me Ediktin e Milanos në vitin 313 pas Krishtit, i dha fund përndjekjeve të gjata të të krishterëve.

Ai e mbështeti kishën me ndihma financiare, e padyshim edhe vet i ishte bashkuar besimit të krishterë, duke e forcuar kështu sidomos rolin e ipeshkvijve.

Sigurisht që qëllimi i tij nuk ishte vetëm fetar, pasi nga pikëpamja politike ai synonte të arrinte unitetin e perandorisë romake pikërisht përmes unitetit të kishës.

Megjithatë, duhet pranuar se ky unitet rrezikohej nga ekzistenca e një debati, që sa vinte e bëhej më i ashpër.

Debatet e ashpra, çuan në konfrontimin që shpërtheu aty rreth vitit 318 në Aleksandrinë e Egjiptit, për tu përhapur më pas kudo e me shpejtësi. Prifti Arius e mohoi hyjninë e Jezu Krishtit, duke dashur kështu që të ruante unitetin dhe pakrahasueshmërinë e Hyjit, që vinte si trashëgimi jo vetëm prej besimit biblik të Izraelit por edhe prej filozofisë greke.

Sipas tij:

Biri i Hyjit nuk mund të kishte ekzistuar i pashkaktuar që nga përjetësia me Atin, nuk ishte i barabartë me Hyjin, por krijesa e parë dhe më e përkryer e Hyjit, që shërbente si mjet për krijimin e botës dhe për krijimin e marrëdhënieve të Hyjit me njeriun.

Arius dhe ndjekësit e tij ishin njohës të thellë të

Biblës dhe të filozofisë, prandaj synonin që ta përshtatnin mesazhin e krishterë me standardet intelektuale të kohës së tyre. Për ta, mishërimi i Hyjit ishte një ide naive. Vlen të thuhet se, shumë njerëz të arsimuar të asaj kohe ndanin këtë mendim. Edhe pasi Ariusi u thirr nga ipeshkvi i tij për të qëndruar besnik ndaj themeleve të krishterimit, konflikti u përshkallëzua më tej. Perandori Konstandin, i shqetësuar, mori iniciativën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke thirrur një sinod të përgjithshëm të kishës. Kështu, në fillim të verës së vitit 325, rreth 250 pjesëmarrës u mbledhën pranë rezidencës perandorake në Nikea (Izniku i sotëm që gjendet në provincën turke të Bursës).

Sinodi, ku ishin të pranishëm si perandori ashtu edhe përfaqësuesit e ipeshkvit të Romës, e dënoi doktrinën e Ariusit dhe të ndjekësve të tij, duke formuluar një rrëfim besimi që konfirmonte pikërisht doktrinën e saktë të kishës.

ÇFARË BESOJMË PËR JEZU KRISHTIN?

Thelbi i këtij rrëfimi është deklarata:

Jezu Krishti, Biri, është nga esenca e Atit, Hyj prej Hyjit, Dritë prej Dritës, Hyj i vërtetë prej Hyjit të vërtetë, i lindur, jo i krijuar, i njëqenshëm me Atin. Termi “i njëqenshëm” (një substancë e vetme) nuk

vinte nga Bibla; ky term ishte një huazim nga gjuha dhe mendimi filozofik grek, për ta ruajtur doktrinën biblike mbi Birin e Hyjit nga keqinterpretimi që krijonte idenë se kjo doktrinë ngjante si një metaforë pa realitet.

Edhe pse debati mbi “Arianizmin” vazhdoi edhe pas vendimeve të këshillit [Koncilit] të Nikesë, ky sinod mbeti vendimtar për besimin e të gjitha konfesioneve të krishtera, duke formuar kështu një bazë të përbashkët e të rëndësishme.

SI E FORMËSOI NIKEA JETËN E KRISHTERË QYSH ATËHERË E DERI MË SOT?

Një tjetër vendim i rëndësishëm i këtij këshilli [koncili], ishte përcaktimi i festës së pashkës në të dielën pas hënës së plotë të parë të pranverës, [-] e ne ende e festojmë pashkën pikërisht në këtë kohë, dhe si për ta përforcuar këtë sjellje tonën, sivjet pashkën do ta festojmë së bashku me ortodoksët.

Në këtë vit që është edhe vit jubilar, përshëndetet çdo nisëm që inkurajon festimin e përbashkët të pashkës nga të gjithë të krishterët.

Mund të ekzistoj një lidhje përbashkuese, midis vendimit të këshillit [koncilit] të Nikesë dhe caktimit të datës së krishtlindjes më 25 dhjetor nga perandori Konstandin, kjo si një shprehje e besimit në Jezusin si Hyji i vërtetë dhe si njeri i vërtetë.

KTHIM TEK RRËNJËT, PRA KTHIM TEK KRISHTI

Të dashur vëllezër dhe motra në fe, nëse ia dola që ta kem vëmendjen tuaj deri këtu, tani po shpresoj që ta zgjoj interesin tuaj mbi rëndësinë e një ngjarjeje e cila ka ndodhur 1700 vjet më parë.

Përtej interesit historik, për ne të krishterët sot a kanë rëndësi ngjarjet dhe vendimet e asaj kohe?

Po, ato kanë rëndësi sepse ato janë edhe origjina e besimit tonë, dhe ne si besimtarë jetojmë duke e respektuar origjinën tonë, pasi pikërisht njohja e origjinës na ndihmon që ta njohim më mirë veten. Unë personalisht, jam pasuruar gjithmonë ndërsa jam gjendur i angazhuar intensivisht me besimin tim, duke zbuluar kështu më thellë thëniet për Zotin trini, kishën, shpëtimin dhe faljen, urdhërimin e dyfishtë të dashurisë ndaj Hyjit dhe ndaj të afërmit, lutjen dhe sakramentet, si dhe duke e kuptuar më mirë perspektivën e madhe të jetës së përjetshme që na vjen si një premtim.

Në fund të fundit, sa herë që bëhet fjalë për Jezus Krishtin dhe për atë që ne besojmë për të, gjithçka lidhen me thelbin kulmor të krishterimit.

BESIMI NË KRISHTIN NË KOHËT E TANISHME

Kemi një sondazh që është kryer me anëtarësinë e kishës, dhe është publikuar në vitin 2023, i cili më shqetëson shumë; sipas këtij sondazhi numri i të anketuarve që pajtohen me deklaratën:

“Unë besoj se ka një Zot që e ka zbuluar veten në Jezus Krishtin!”

ka rënë në mënyrë dramatike krahasuar me sondazhet e mëparshme. Sot, vetëm 32 për qind e anëtarëve të kishës katolike pajtohen me këtë deklaratë. Dikush mund ta konsideroj këtë si pasojë e zhvillimeve laike përgjithësisht në rritje, sipas të cilave ekzistenca e Zotit është bërë pak a shumë e pakuptimtë për gjithnjë e më shumë njerëz. Megjithatë ky avullim mbi një koncept kaq personal mbi Zotin, shoqërohet padyshim me një rrallim shqetësues të përmbajtjeve fetare themelore të besimit të krishterë. Çdo brez të krishterësh, e mbi të gjitha secili nga ne,

duhet të jetë në gjendje që tu përgjigjet pyetjeve të tilla si:

Kush ishte në të vërtetë Jezu Krishti? (dhe)

Kush është Jezusi?

Dhe një prej përgjigjeve vjen kështu:

Ai është modeli, profeti, rabini nga Nazareti, një figurë që ka shënjuar historinë botërore;

mirëpo këto përgjigje dhe shumë përshkrime të tjera, vazhdojnë që të ndeshen me shumë simpati shumë përtej kufijve të kishës, siç e konfirmojnë anketat vazhdimisht.

Por a mjafton e gjithë kjo, që një qenie njerëzore të jetë në gjendje që të jetojë një jetë me besim në Jezu Krishtin? A mjafton e gjithë kjo që njeriu të jetoj mirë dhe të vdes mirë në atë që beson?

LINDUR PREJ ATIT PARA GJITHË KOHËVE – PËR NE NJERËZIT DHE PËR SHPËTIMIN TONË

Atanasi i Aleksandrisë, konsiderohet si një prej ipeshkvinjve dhe teologëve më të rëndësishëm të shekullit të katërt pas Krishtit.

Ai u përgatit dy herë radhazi që të shkonte në mërgim nga Egjipti e deri në fund të botës, domethënë në Trier, për hir të Kredos së Nikesë.

Ai e ruajti fenë dhe besimin e tij, duke prezantuar tre arsye më të thella për vendimin e Nikesë:

Nëse Krishti, Biri, nuk do të ishte Hyj, atëherë ai nuk do të kishte qenë në gjendje që të na e zbulonte Hyjin në njerëzve ashtu siç është.

Ai do të ishte thjesht një në linjën e ndërmjetësve dhe të profetëve; ai mund të komunikonte diçka për Zotin, por jo vet Zotin.

Dhe nëse vet Zoti nuk do të ishte bërë njeri, atëherë asgjë nuk do të mund të kishte ndryshuar realisht për shpëtimin e të gjithë njerëzve përmes jetës, shpalljes së Mbretërisë së Hyjit, vuajtjes, vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit, në një mënyrë kaq shëlbuese dhe çliruese.

Nëse do të besojmë në një liri të brendshme të re dhe të vërtetë, dhe në një marrëdhënie të re me Hyjin e cila mund të shërohet nga mëkati dhe nga faji, atëherë do të ishim në rrugën e gabuar me besimin tonë.

Së fundi, mësuesi i kishës, atë Atanasi, argumenton:

Nëse Jezu Krishti do të ishte vetëm një krijesë dhe jo me të vërtetë Biri i Hyjit, atëherë do të ishte idhujtari që njeriu t'i lutej atij, të gjunjëzohej përpara tij dhe ta adhuronte atë. Biseda personale me Jezusin dhe çdo lutje në shërbimin e kishës mund të kenë një efekt psikologjik pastrues dhe motivues,

por përtej kësaj ato nuk mund të krijojnë kurrë një lidhje të vërtetë mes ne njerëzve dhe Zotit, që është origjina, baza dhe qëllimi i jetës sonë.

Këto argumente me peshë, ende më duken shumë bindëse.

KULTURA E SINODALITETIT DHE DËSHMIA E PËRBASHKËT E KRISHTERË

Përveç çështjes së natyrës dhe të origjinës së Shpëtimtarit tonë, e cila ishte kaq urgjente në atë kohë, ia vlen që këshilli [koncili] i Nikesë të konsiderohet edhe për disa arsye të tjera. Kjo ngjarje e rëndësishme na tregon se gjatë historisë së kishës, ka pasur mosmarrëveshje të përsëritura për çështje thelbësore të besimit, për qëndrimet morale themelore, si dhe për orientimin e kishës në lidhje me të tashmen. Konfliktet dhe diskutimet janë gjithmonë pjesë e natyrshme e saj.

Ne mund t'i vazhdojmë edhe sot ato debate e diskutime; ne edhe sot mund t'i shtrojmë pyetjet tona duke besuar se qysh herët kisha ka zhvilluar një kulturë si dhe struktura të posaçme sinodaliteti, duke debatuar me njëri-tjetrin me qëllim që besimi ynë të mund të thellohet dhe të zhvillohet më tej, gjithmonë duke e ruajtur dhe rizbuluar njëherësh edhe unitetin brenda kishës.

Prandaj, rezultatet e sinodit botëror 2021-2024 mbi temën e “sinodalitetit”, të cilat tashmë duhet të zbatohen me guxim në të gjitha nivelet e kishës botërore, janë pjesë e një tradite sa të gjatë aq edhe të mirë.

Në atë kohë, shqetësimi kryesor i perandorit romak ishte që, kisha të mos shpërbëhej në rrëfimin e saj për Jezun Krishtin; dhe të kesh një pritshmëri të tillë për kishën, nuk është aspak një sjellje arrogante.

Në sytë e shumë njerëzve, uniteti mbetet si dëshmia më vendimtare e besimit të krishterë.

Vetë Jezusi u lut që “të gjithë të jenë një, [...] që bota të besojë” (Gjoni 17,21).

Unë shpesh e përjetoj këtë në diskutime me grupet shoqërore, por edhe me vendimmarrësit politikë; dhe kam kuptuar se ata edhe nëse nuk besojnë personalisht, përsëri besojnë se ne të krishterët, në frymën e Jezusit, punojmë përtej gjithë kufijve fetarë, për drejtësinë në botë, për kohezionin njerëzor si dhe për orientimin e bazuar në vlerat dhe qëndrimet themelore.

Kjo është arsyeja se pse, përpjekja ekumenike për një bashkësi më të madhe dhe për një unitet më të dukshëm, është kaq e rëndësishme sot.

BUKURIA DHE SAKTËSIA E BESIMIT

Ju falënderoj të gjithë ju, të dashur vëllezër e motra në fe, për gjithë angazhimin tuaj ndaj besimit të krishterë dhe ndaj jetës kishtare në kohën tonë e, mbi të gjitha, ju falënderoj për dëshminë tuaj personale.

Duke qenë se jemi në një vit përvjetor, unë do të dëshiroja që t'ju inkurajoja që ju të reflektoni mbi besimin tuaj në Jezu Krishtin, si në nivel individual ashtu edhe në nivel bashkësie. Kam disa pyetje për të cilat ju duhet të reflektoni, të tilla si:

Çfarë do të thotë për ju Jezu Krishti?

Si arrini që t'i përmbushni thëniet e rëndësishme të kredos në jetën tuaj? (dhe)

Si flisni me Jezusin, kur i luteni?

Kur e zbatoj kredon, unë jo vetëm që ndjej diçka prej saktësisë së thellë të besimit, por më prek edhe bukuria e tij. Kredoja e Madhe në veçanti, është një himn që i kushtohet tërësisht Zotit, dhe pikërisht e me të drejtë kjo është edhe arsyeja se pse ajo kryesisht këndohet, pra këndohet, jo thjesht recitohet; pasi besimi ynë i gjallë është vet mënyra themeltare e adhurimit tonë.

E në përfundim, për ju dhe për të gjithë ata që janë të lidhur me ju, kërkoj bekimin e begatë të Zotit, në emër të Atit, dhe të Birit dhe të Shpirtit Shenjt. Amen.

Limburg, e diela e dytë e kreshmës, viti 2025

+ Ipeshki juaj

BESOJMA E MADHE OSE NIKEO-KONSTANDINOPOLITANE

Besoj në një Hyj të vetëm,
Atin e gjithëpushtetshëm,
Krijuesin e qiellit e të tokës,
të gjitha sendeve që shihen dhe që nuk shihen.

Besoj në një Zot të vetëm, Jezu Krishtin,
një të vetmin Birin e Hyjit,
të lindur prej Atit para të gjithë shekujve.
Hyj prej Hyjit, Dritë prej Dritës,
Hyj i vërtetë prej Hyjit të vërtetë.
I lindur, jo i krijuar, i njëqenshëm me Atin,
nëpërmjet të cilit janë krijuar të gjitha sendet.
Ai, për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë,
zbriti prej qiellit.
E u mishërua për virtyt të Shpirtit Shenjt
prej Virgjërës Mari dhe u bë njeri.

U kryqëzua për ne nën Poncin Pilat,
pësoi dhe u varros,
dhe u ngjall të tretën ditë sipas Shkrimeve,
e u ngjit në qiell dhe rri në të djathtën e Atit.
Dhe përsëri do të vijë me lavdi
për të gjykuar të gjallët e të vdekurit,
e mbretëria e tij nuk do të ketë mbarim.
Besoj në Shpirtin Shenjt,
që është Zot dhe jetëdhënës,
që rrjedh prej Atit e prej Birit,
që me Atin e me Birin adhurohet
e lavdërohet,
që foli me anë të profetëve.

Edhe një Kishë të vetme, të shenjtë,
katolike dhe apostolike.

Dëshmoj një pagëzim të vetëm për faljen
e mëkateve.

Pres ngjalljen e të vdekurve dhe jetën
e pasosur.

Amen

FTESË PËR LUTJE

- ① Krisht, Zot hyjnor,
Ty të do, vetëm ai që ka forcë të dojë:
pavetëdijshtëm, ai që nuk të njeh;
plot mallëngjim, ai që di për ty.
- ② Krisht, ti je shpresa ime,
Paqja ime, lumturia ime, gjithë jeta ime:
Krisht, shpirti im priret drejt teje;
Kriht, unë të adhuroj ty..
- ③ Krisht, unë mbahem për ty fort
me gjithë forcën e shpirtit tim:
vetëm ty, Zot, të dua,
të kërkoj, të ndjek.

T: Libri i liturgjisë së orëve, Christe Deus, vitae verae fabricator, Alphanus Salerno, (+1085)



1 Chri - stus, gött - li - cher Herr, dich__
2 Chri - stus, du bist mei - ne Hoff - nung, mein
3 Chri - stus, an dir__ halt ich fest mit der



1 liebt, wer nur Kraft__ hat zu lie - ben:
2 Frie - de, mein Glück, all mein Le - ben:
3 gan - zen__ Kraft__ mei - ner See - le:




1 un - be - wusst, wer__ dich nicht kennt;
2 Chri - stus, dir neigt sich mein Geist;
3 dich,__ Herr, lieb__ ich al - lein,



1 sehn - sucht - voll,__ wer um dich weiß.
2 Chri - stus, dich be - te ich an.
3 su - che dich,__ fol - ge dir nach.

T: Stundenbuch nach „Christe Deus, vitae verae fabricator“.
Alphanus von Salerno (+1085), M: Barbara Kolberg 2008



Übersetzung der Ausgabe:
„GOTTES SOHN – MENSCH FÜR UNS“
HIRTENWORT
zur Österlichen Bußzeit 2025
von Dr. Georg Bätzing, Bischof von Limburg